



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 1 pika 1.3 paragrafi (ç), pika 1.7 paragrafi (d) të Rregullores 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Mbështetur në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare neni 11.

Duke pasur parasysh fushëveprimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përkitazi me politikatat e veprimit për mbrojtjen e familjeve dhe të miturve.

Me qëllim të rregullimit, avancimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare për fëmijët pa kujdes prindëror, **Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr 05/2006
PËR
THEMELIMIN E PANELIT PËR VENDOSJEN E FËMIJËVE PA
KUJDES PRINDËROR NË STREHIM FAMILJAR DHE BIRËSIM
(ADOPTIM)**

Neni 1

Qëllimi

(1) Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin e procedurave për themelimin e Panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, në strehim familjar dhe birësim (adoptim), (në tekstin e mëposhtëm paneli), në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, si dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësisive të këtij paneli.

Neni 2

Procedurat për Themelimin e Panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe birësim (adoptim)

(1) Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, përmes këtij Udhëzimi Administrativ e autorizon Departamentin e Mirëqenies Sociale, që në emër të Ministrisë ta merr nismën për themelimin e panelit.

(2) Paneli themelohet me emërimin e anëtarëve nga Ministri i MPMS, në përputhje me nenin 11 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

(3) Paneli për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe birësim, drejtohet nga drejtori i Departamentit të Mirëqenies Sociale, ose nga një person tjetër i caktuar nga ai, dhe përbëhet nga shtatë zyrtar të DMS dhe institucioneve tjera të kësaj fushe, në bazë të ekspertizës dhe përvojës së tyre përkatëse profesionale.

Paneli përbëhet prej këtyre institucioneve:

1. Drejtori i Departamentit të Mirëqenies Sociale,
2. Udhëheqësi i Divizionit të Shërbimeve Sociale,
3. Zyrtari i Lartë profesional për Strehim familjar, birësim vendor dhe ndërkombëtar,
4. Dy përfaqësues nga Qendrat për Punë Sociale të Kosovës,
5. Një përfaqësues nga Instituti i Politikës Sociale dhe
6. Një përfaqësues nga Organizatat joqeveritare.

(4) Mbledhjet e panelit mund të mbahen vetëm nëse janë të pranishëm të paktën pesë (5) anëtar të tij.

(5) Vendimet e panelit do të jenë të plotfuqishme, nëse për to votojnë shumica anëtarëve të pranishëm.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Panelit

(1) Paneli për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe birësim ka për detyrë që:

1. Të përkujdeset për realizimin e funksioneve në përputhje me nenin 11 paragrafi 11.9, të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare,
2. T'i shqyrtojë raportet e nëpunësit të shërbimeve sociale të miratuara nga DMS, lidhur me prindërit e mundshëm për vendosjen e fëmijëve në strehim familjar,

3. Të vendos për përfshirjen e prindërve të mundshëm të strehimit familjar në regjistrin unik të prindërve strehues familjar në Kosovë,
4. Të shqyrtojë nevojat e fëmijëve dhe përshtatshmërinë e prindërve lidhur më vendosjen e fëmijëve te prindërit strehues familjar,
5. Të vendos lidhur më heqjen e fëmijëve nga përkujdesja prindërore tek të cilët janë në strehim familjar, për shkak të vendosjes së pasuksesshme apo të papërshtatshme,
6. Të përkujdeset për mbajtjen e regjistrit të personave, të cilët janë përcaktuar si prindër birësues nga nëpunësit e shërbimeve sociale,
7. Të mbrojtë të drejtat e fëmijëve në përputhje më aktet ndërkombëtare, nëse këta fëmijë janë subjekt i kërkesave për birësim nga njerëzit që jetojnë jashtë vendit.

Neni 4

Rregullat e veprimit dhe të funksionimit të Panelit lidhur më Strehimin familjar të fëmijëve pa kujdes prindëror

(1) Departamenti i Mirëqenies Sociale mban një regjistër unik të fëmijëve pa kujdes prindëror, me mundësi strehimi familjar në bazë të referimeve nga QPS e vendit.

(2) Fëmijë pa kujdes prindëror konsiderohet fëmija prindërit e të cilit nuk janë gjallë, janë të panjohur, të zhdukur apo prindërit e të cilit për çfarëdo arsye, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nuk i kryejnë detyrat e tyre prindërore. (Neni 156 i Ligjit i për Familjen).

(3) Departamenti i Mirëqenies Sociale mban një regjistër unik të prindërve të mundshëm për strehim familjar në bazë të referimeve nga QPS- të.

1. Regjistri është një libër unik në të cilin do të evidencohen fëmijët pa kujdes prindëror dhe prindërit e mundshëm strehues dhe birësues.

(4) Prindër të mundshëm për strehim familjar, llogariten ata të cilët kanë aplikuar në QPS-të vendore për të qenë strehues familjar, ndërsa QPS-të i kanë vlerësuar pozitivisht dhe i kanë trajnuar për të qenë familje strehuese.

(5) Regjistrat do të përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për menaxhim efektiv të shërbimeve strehuese, duke përfshirë të dhënat dhe numrin e fëmijëve në pritje për strehim familjar si dhe të prindërve të mundshëm strehues. DMS ka përgjegjësi që të mbajë regjistra të saktë të fëmijëve në pritje për strehim familjar, dhe prindërve të mundshëm strehues sipas referimeve të QPS. DMS këtë përgjegjësi e realizon përmes personave të autorizuar për këtë formë të mbrojtjes (neni 3.3.1 i këtij Udhëzimi Administrativ).

(6) Mendimin në lidhje me vendosjen e fëmijës së caktuar te prindërit strehues e jep paneli, duke e respektuar mirëqenien e fëmijës dhe përshtatshmërinë e prindërve strehues.

(7) Vendimin për vendosjen e fëmijës në strehim familjar e merr Qendra për Punë Sociale në bazë të kompetencës lëndore dhe territoriale, pas marrjes së mendimit nga paneli.

(8) Fëmija vendoset në një familje, e cila me familjen e tij biologjike ka të përbashkët prejardhjen etnike, gjuhësore, kulturore dhe religjioze.

(9) Përjashtimisht nga neni 4.8, fëmija mund të vendoset edhe në familje tjera strehuese nëse kjo është më e përshtatshme për mirëqenien e fëmijës.

(10) Strehimi familjar është një formë e mbrojtjes që aplikohet nga shërbimet e MPMS vetëm brenda territorit të Kosovës.

(11) Departamenti i Mirëqenies Sociale do të mbështes strehimin familjar, si formë me prioritet të përkujdesjes së fëmijëve pa kujdes prindëror, dhe për këtë arsye do të ndërmarrë aktivitete për informimin e publikut dhe aktivitete tjera përkrahëse.

(12) Menaxheri i caktuar nga QPS që udhëheq rastin e fëmijës së vendosur në strehim familjar, është i obliguar që së paku njëherë në muaj ta vizitoi fëmijën, dhe për këtë duhet të mbajë shënime në formë profesionale të punës për menaxhim të rastit.

(13) Të gjitha vlerësimet lidhur me shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës në strehim familjar, bëhen nga Qendra për Punë Sociale, përmes menaxherit të caktuar për udhëheqjen e rastit.

1. Për veprimet e caktuara që shkojnë në interes të mirëqenies së fëmijës, menaxheri i rastit është i obliguar që ta njoftoi dhe ta merr pëlqimin e kujdestarit ligjor të fëmijës.

(14) Në rast se gjatë strehimit familjar, menaxheri i rastit ka vlerësuar se nuk janë përmbushur interesat e fëmijës, paneli do të kërkoj ndërprerjen e strehimit familjar pas referimit që e bënë organi i kujdestarisë, si dhe heqjen nga regjistri përkatës të familjes strehuese, për shkak të mos respektimit të kriteve të parashikuara të strehimit familjar për mirëqenien e fëmijës.

(15) Nëse gjatë strehimit familjar, një fëmijë lëndohet ose vdes, është detyrë e MPMS që përmes shërbimeve të saj, të iniciojë zhvillimin e procedurave hetimore për rrethanat, dhe të ndërmarrë çdo masë të nevojshme pasuese.

Neni 5

Rregullat e veprimit dhe të funksionimit të Panelit lidhur me birësimin (adoptimin) e fëmijëve pa kujdes prindëror

(1) Departamenti i Mirëqenies Sociale, e mban një regjistër unik të fëmijëve pa kujdes prindëror që presin për birësim, në bazë të referimeve nga QPS-të e vendit.

(2) Fëmijë në pritje të birësimit, është fëmija pa kujdes prindëror me status ligjor të zgjidhur.

(3) Departamenti i Mirëqenies Sociale, e mban një regjistër unik të prindërve të mundshëm birësues, në bazë të referimeve nga QPS-të vendore.

(4) Prindër të mundshëm birësues, konsiderohen prindërit që kanë aplikuar në QPS për birësim, dhe që janë vlerësuar pozitivisht nga QPS, si prindër të përshtatshëm që garantojnë mirëqenien e fëmijës.

(5) Regjistri do të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme, duke përfshirë të dhënat dhe numrin e fëmijëve që presin për birësim si dhe të prindërve të mundshëm birësues. DMS ka përgjegjësi që ta mbajë në rregull regjistrin e fëmijëve që presin për birësim dhe prindërve të mundshëm birësues, në bazë të referimeve të QPS. DMS, këtë përgjegjësi e realizon përmes personave të autorizuar për këtë formë të mbrojtjes (neni 3.3.1 i këtij Udhëzimi Administrativ).

(6) QPS është e obliguar që t'i drejtohet me shkrim panelit për marrjen e mendimit për birësim.

(7) Mendimin për birësim e jep paneli, duke respektuar mirëqenien e fëmijës dhe përshtatshmërinë e prindërve të mundshëm birësues.

(8) Vendimin për themelimin e birësimit e merr Qendra për Punë Sociale ose Gjykata, në bazë të kompetencës lëndore dhe territoriale.

(9) Fëmija birësohet vetëm në atë familje, e cila me familjen e tij biologjike ka të përbashkët prejardhjen etnike, gjuhësore, kulturore dhe religjioze.

(10) Përfundimisht nenit 5.9, fëmija mund të birësohet edhe në familje tjera jashtë Kosovës, nëse për këtë ekzistojnë arsyet e duhura që shkojnë në favor të mirëqenies së fëmijës.

(11) Prindër të mundshëm birësues ndërkombëtar, konsiderohen prindërit me vendbanim (vendqëndrim) jashtë Kosovës, të cilët janë vlerësuar pozitivisht nga shërbimet sociale në vendin ku jetojnë, dhe që e dërgojnë dokumentacionin për të aplikuar për birësim në DMS. Dokumentacioni duhet të jetë i vulosur me vulë Apostile, dhe brenda mundësive, për vlefshmërinë e tij, do të diskutohet me Zyrat e Ndërlidhjes në Kosovë prej nga aplikojnë qytetarët.

(12) Për veprimet e caktuara që shkojnë në interes të fëmijës, menaxheri i rastit është i obliguar që ta njoftoj dhe ta marrë pëlqimin e kujdestarit ligjor të fëmijës.

(13) QPS është e obliguar që ta zhvilloi procedurën para birësuese (para adoptuese) të fëmijës, e cila nuk do zgjasë më shumë se tre muaj.

1. Gjatë periudhës para birësuese, menaxheri i rastit nga QPS, është i obliguar që ta vizitoj fëmijën së paku një herë në muaj, në mënyrë që të bindet për mirëqenien e fëmijës, dhe lidhjen emocionale të krijuar mes fëmijës së birësuar dhe prindërve birësues.

(14) Në rast se gjatë periudhës para birësuese, menaxheri i rastit ka vlerësuar se nuk janë përmbushur interesat e fëmijës, paneli do të kërkoj ndërprerjen e birësimit, pas referimit që e bënë organi i kujdestarisë, si dhe heqjen nga regjistri të prindërve birësues, për shkak të mos respektimit të kritereve të periudhës para birësuese për mirëqenien e fëmijës.

(15) Nëse gjatë periudhës para birësuese, një fëmijë lëndohet ose vdes, është detyrë e MPMS që përmes shërbimeve të saj, të inicioj zhvillimin e procedurave hetimore për rrethanat, dhe të ndërmarrë çdo masë të nevojshme pasuese.

(16) Në rastin e realizimit të birësimit me element ndërkombëtar, periudha para birësuese do të jetë së paku dy javë, dhe vlerësimi do të bëhet nga QPS-ja që e menaxhon rastin e fëmijës.

(17) Paneli mund t'ua merr përparësinë në regjistër prindërve të mundshëm birësues, të cilët refuzojnë ose e braktisin fëmijën i cili u është propozuar për birësim nga paneli.

(18) Çdo person i cili e bën birësimin në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji, ose tenton që ta bëjë këtë, ndëshkohet për vepër penale në bazë të ligjeve në fuqi.

(29) Çdo profesionist që ushtron presion të panevojshëm ndaj një prindi ose prindërve për ta dhënë fëmijën e tyre për birësim, konsiderohet fajtor për shkelje flagrante profesionale, dhe i nënshtrohet ndjekjes penale në bazë të ligjeve në fuqi.

(20) Në mënyrë që ti mbrojë të drejtat e fëmijëve, të cilët mund të jenë subjekt i kërkesave për birësim nga njerëzit që jetojnë jashtë Kosovës, paneli ka obligim që:

1. Të sigurojë se ka përputhshmëri me kërkesat e Konventës së Hagës mbi të Drejtën Private, Konventën për Mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në lidhje me birësimin ndërshtetëror,
2. Të sigurohet se janë zhvilluar të gjitha procedurat dhe veprimet nga QPS-të e vendit, që fëmija në pritje për birësim, të birësohet në Kosovë para se të vendoset për birësimin e tij me element ndërkombëtar,
3. T'i mbrojë të gjithë fëmijët e mundshëm për birësim, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, gjinore, kulturore, religjioze, gjendjen shëndetësore, etj.

4. Të vendosë dhe të zhvilloi marrëdhënie bashkëpunimi me organet përkatëse për birësim në vendet e mundshme pranuese, duke siguruar kështu, së paku dy raporte me shkrim për mirëqenien e fëmijës, gjatë dy viteve të para pas birësimit.
5. Të zhvilloi marrëdhënie bashkëpunimi me zyrat e huaja të ndërlidhjes në Kosovë, për verifikimin e vlefshmërisë së dokumentacionit për birësim me element ndërkombëtar, të palëve të mundshme birësuese.
6. T'i vendosë kriteret që duhen zbatuar për birësim.
7. T'i mundësoi procedurat e nevojshme ligjore për kryerjen e birësimit ndërshtetëror, siç përcaktohet nga Konventa e Hagës.

Neni 6

Rregullat për punën e Panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe birësim (adoptim)

Paneli për punën e vet do të nxjerr rregullore pune, e cila nuk guxon të jetë në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në legjislacionin e aplikueshëm të kësaj fushe në vendin tonë.

Neni 7

Kohëzgjatja e shërbimit në Panel për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe birësim (adoptim)

(1) Mandati i shërbimit të anëtarëve të panelit, për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe birësim është dy vjet, me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat. Asnjë anëtar i panelit nuk mund ta kryej këtë funksion më shumë se katër vjet (dy mandate), përveç Drejtorit të Departamentit të Mirëqenies Sociale, Udhëheqësit të Divizionit të Shërbimeve Sociale dhe Zyrtarit të Lartë për Strehim familjar, birësime vendore dhe ndërkombëtare, të cilët do të jenë të përhershëm në ushtrimin e detyrës së tyre profesionale në panel.

(2) Nëse një anëtar i panelit ka dështuar në kryerjen e punëve profesionale që rrjedhin nga rregulloret e panelit, pas shqyrtimit të dëshmimeve, anëtarët e panelit mund të propozojnë përjashtimin e anëtarit që ka rënë ndesh me detyrat dhe përgjegjësitë e panelit.

(3) Nëse anëtari i panelit mungon në tri mbledhje radhazi, nuk e respekton ruajtjen e të dhënave sekrete, si dhe nëse manifeston sjellje jo serioze, që bien ndesh me etikën e punës profesionale, mund të vije deri tek përjashtimi i tij nga paneli.

(4) Në të gjitha rastet kur pushon aktiviteti e një anëtari të panelit, emërohet anëtari i ri që shërben për kohën e mbetur nga mandati i anëtarit paraprak. Anëtari i ri propozohet nga subjekti të cilin e ka përfaqësuar anëtari i mëparshëm.

Neni 8

Institucionet përgjegjëse për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe birësim (adoptim)

(1) MPMS, gjegjësisht Departamenti i Mirëqenies Sociale përmes Qendrave për punë Sociale, është përgjegjës për realizimin dhe mbikëqyrjen e politikave dhe programit të përgjithshëm të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë, përkatësisht vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe birësim.

(2) Qendrat për Punë Sociale, OJQ profesionale dhe shtëpitë me bazë në komunitet që ofrojnë shërbime sociale, janë përgjegjëse për zbatimin korrekt të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Priština, jula 2006

Ministar MRSZ-a
.....
Ibrahim Selmanaj